



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 4.3.2021, ora 15:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24 shkurt 2021.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha Gjebrea, Alket Hyseni, Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ligoraq Karamelo, Andrea Marto, Vasilika Hysi, Zef Shtjefni dhe Ditmir Bushati.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Halit Valteri, Reme Lala, Fatmir Velaj dhe Ediola Braha.

Të ftuar:

Agron Tare – Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Inida Methoxha – Drejtoreshë e Komanduar e Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane

Ermira Gjeçi – Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Lauresha Grezda – Drejtoreshë e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Besart Kadia – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Joniada Barjaba – Drejtoreshë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në MFE

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 04 mars 2021.

Sot në rendin e ditës kemi: miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 24 shkurt 2021; projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relator kemi kolegun Bushati.

Të ftuar për të diskutuar për projektligjin kemi zotin Agron Tare, zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme. Mirë se vini, zoti Tare! Kemi Zonjën Methoxha, drejtoreshë e Komanduar e Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane. Mirë se vini, zonja Methoxha! Kemi zonjën Gjeçi, zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mirë se vini, zonja zëvendësministre! Kemi zonjën Grezda, drejtoreshë e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mirë se vini, zonja Grezda! Kemi zotin Kadia, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë. Mirë se vini, zoti Kadia! Kemi zonjën Barjaba, drejtoreshë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Mirë se vini, zonjë!

Fillojmë pa humbur kohë.

Kush është dakord me procesverbalin e datës 24 shkurt?

Shikoj që jemi të gjithë dakord.

Faleminderit!

Miratohet.

Vazhdojmë me diskutimin e projektligjit.

Nëse nuk gaboj, fillimisht projektligjin e prezanton zoti Tare.

Zoti Zëvendësministër, fjala për ju.

Agron Tare – Faleminderit, zonja kryetare!

Sot kemi ardhur në komision për të prezantuar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”. Ky projektligj është i nevojshëm, pasi marrëveshja është e nevojshme për shkak të daljes së Britanisë së Madhe dhe Irlandës nga Bashkimi Europian. Ne propozojmë ratifikimin nga Kuvendi, pasi e shikojmë me shumë rëndësi, sepse Britania e Madhe është një partner strategjik i Shqipërisë, pavarësisht se nuk është i perceptuar në politikën e jashtme. Përputhja me programin e qeverisë qëndron.

Argumentimi: synon të ruajë marrëdhëniet ndërmjet palëve të krijuar nga lidhja e përcaktuar në nenin 1 të marrëveshjes Shqipëri-Bashkimi Europian. Në qoftë se ka pyetje nga kolegët deputetë, jeni të mirëpritur.

Mimi Kodheli – Zonja Gjeci, fjala për ju.

Ermira Gjeçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Referuar kësaj marrëveshjeje në lidhje me produktet bujqësore dhe ato të peshkut, është bërë një rivlerësim i kuotave tarifore që Shqipëria ka me Bashkimin Europian, sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe koncesionet shtesë në lidhje me produktet e përfshira në kapitujt VII, që janë zarzavatet, dhe VIII që janë frutat të nomenklaturës së kombinuar dhe produkteve të verës.

Në lidhje me produktet me kuota tarifore, si kuotat e aplikuara nga Mbretëria e Bashkuar për produktet shqiptare edhe ato të aplikuar nga Shqipëria për produktet që origjinojnë në Mbretërinë e Bashkuar, do të jenë për të njëjtat produkte si me Bashkimin Europian dhe koeficienti do të jetë 13,62% e kuotave të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Dua të nënvizoj faktin se, pavarësisht dëshirës sonë për të negociuar për kuotat për rritjen e tyre, ka qenë një pikë e panegociueshme, e njëjta përqindje është aplikuar edhe te vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, pasi ka të bëjë me volumet e eksporteve dhe importeve.

Lidhur me produktet me origjinë në Shqipëri, të përfshira në kapitujt VII dhe VIII të nomenklaturës së kombinuar, pranoen për import në Mbretërinë e Bashkuar, duke u përjashtuar (kjo është një shtesë e bërë në aneks) nga detyrimet doganore dhe tarifatat specifike që kanë efekt ekuivalent.

Lidhur me produktet e verës, krahas kuotës tarifore prej 953 hl, krahas kuotës tarifore prej 953 hl (272 hl + 681 hl), sipas marrëveshjes preferenciale për verërat me origjinë nga Shqipëria, aplikohet edhe një kuotë shtesë prej 681 hl, e cila aplikohet pas shterimit të kuotave tarifore të sipërpërmendur. Këto marrëveshje preferenciale kanë një afat ligjor pesë vjet dhe pas mbarimi të këtij afati ligjor hapet mundësia për të negociuar me Mbretërinë e Bashkuar.

Ekziston një potencial i pashfrytëzuar ende i rritjes së bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar ndërmjet dy shteteve tona, për këtë qëllim miratimi i marrëveshjes do të nxisë thellimin e bashkëpunimit ekonomik midis dy shteteve.

Faleminderit!

Jam e hapur për çdo pyetje nga anëtarët e komisionit.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Fjalën e ka zëvendësministri, zoti Kadia.

Besart Kadia- Faleminderit për fjalën!

Përshëndetje deputetë!

Ashtu siç u tha edhe më parë, referuar edhe të dhënave të INSTAT-it, është një potencial i pashfrytëzuar ende i rritjes së bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar.

Qëllimi i këtij ratifikim dhe hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje do të thellonte shkëmbin tregtar dhe eksportet shqiptare drejt Mbretërisë së Bashkuar.

Me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, mallrat me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga Shqipëria do të përfitojnë trajtim tarifor preferencial reciprok të njëjtë me atë që kanë përfituar kur Mbretëria e Bashkuar ishte pjesë e Komunitetit Europian dhe palë e kësaj MSA-je.

Bizneset shqiptare dhe shumë importues nga Anglia kanë ngritur shqetësimin ose nevojën e këtij ratifikimi dhe për të ditur më tej që ka një impakt ekonomik që duhet marrë parasysh në këtë këndvështrim.

Për çdo pyetje shtesë jemi të hapur.

Mimi Kodheli - Ju falënderoj!

Fjalën e ka kolegu Bushati, relator.

Ervin Bushati- Përshëndetje kryetare!

Të nderuar kolegë,

BREX-it sot është një realitet i politikës, por, patjetër, edhe i tregtisë dhe ekonomisë europiane. Neve na duhet që me Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut të lidhim një marrëveshje të tillë, që do të ketë ndikime.

Unë shpresoj që angazhimi jo vetëm politikisht i Mbretërisë së Bashkuar në zonën e Ballkanit Perëndimor, por edhe ai ekonomik e tregtar ndoshta do të marrë një shtysë të veçantë, meqenëse i gjithë konfigurimi i politikës së jashtme dhe asaj ekonomike në Britaninë e Madhe dhe të Irlandën e Veriut tashmë po merr një dimension tjetër, saqë nga pikëpamja bilaterale do të jetë më shumë i angazhuar. Kështu që shpresoj të marrë votat e të gjithëve. Nuk mendoj se ka ndonjë gjë për t'u diskutuar shumë, por shpresoj që ta rrisim sa më shumë potencialin tonë të marrëdhënies ekonomike, jo thjesht të marrëdhënieve diplomatike dhe politike.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, koleg!

Atëherë, kush e do fjalën për pyetje, komente ose qartësime?

Fjalën e ka fillimisht zoti Karamelo dhe pastaj nënkryetari Gjoni.

Zoti Karamelo, nuk dëgjoheni.

Tani po, mund të flisni.

Ligoraq Karamelo – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit edhe të ftuarve për sqarimet dhe për shpjegimet që dhanë për këtë projektligj!

Ndoshta do të ishte me interes në kuadrin e anëtarëve të komisionit, por edhe në përgjithësi, të dinim se cilat janë marrëdhëniet e tanishme të vendit tonë me Britaninë e Madhe pas daljes së saj nga Bashkimi European? A kemi ne njëfarë pavarësie në drejtim të trajtimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me të apo jemi të pavarur ne në...(Nuk dëgjohet.)

Mimi Kodheli – Zoti Karamelo, megjithëse nuk është dëgjuar e gjithë pyetja juaj. besoj që zëvendësministrat prezentë e kanë kuptuar thelbin e pyetjes.

Nënkryetari Gjoni, fjala për ju.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit zëvendësministrave për prezantimin konçiz!

Patjetër, unë besoj se të gjithë duhet ta mbështesim këtë marrëveshje, sepse, në fund të fundit, rirregullojmë marrëdhënien tonë bilaterale me Mbretërinë e Bashkuar, me sa kuptoj unë, pak a shumë, në nivelin që ne kemi pasur deri tani në kuadrin e Bashkimit European. Por kam një pyetje për zëvendësministren Gjeçi, sepse mendoj që ne duhet të jemi më *smart* me Britaninë e Madhe, për shkak të potencialit të jashtëzakonshëm që paraqet ky treg për produktet tona.

Në nenin 8 të marrëveshjes ju e keni lënë të hapur mundësinë e liberalizimit të mëtejshëm, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, të shkëmbimeve tregtare bilaterale mes dy vendeve tona. A keni ndërmend një *action plan* ose një kornizë kohore për sa u përket hapave të mëtejshëm që do të ndiqen në frymën e nenit 8. Pra, si e parashikoni ju rritjen e vëllimit të eksporteve tona bujqësore apo edhe të produkteve të industrisë së agropërpunimit shqiptar, drejt tregut britanik?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Teknika të më thotë, Karamelo është prapë në linjë.

Ju lutem, edhe një herë kolegun Karamelo, ta kemi në linjë, për të riformuluar edhe një herë pyetjen e tij.

Ligoraq Karamelo – Më dëgjoni?

Mimi Kodheli – Po, tani të dëgjojmë. Fjala për ju.

Ligoraq, ju lutem, nëse më dëgjoni hapni mikrofonin. Nuk dëgjoresh. Ligoraq. Ju lutem, mbyll videon dhe hap mikrofonin.

Ligoraq Karamelo – Më dëgjoni?

Mimi Kodheli – Ju lutem, mbylleni videon edhe hapni mikrofonin.

Ligoraq Karamelo – Ta provojmë njëherë.

Mimi Kodheli – Tani dëgjoresh. Mund të vazhdoni, ju lutem.

Ligoraq Karamelo – Pyetja ime konsiston në faktin që a jemi ne krejtësisht të pavarur në lidhje me bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe, dhe Irlandës së Veriut, tani që këto dy vende kanë dalë nga Bashkimi Europian apo ende, si të thuash, kërkojmë një lloj kredibiliteti lidhur me raportin që kanë aktualisht BE-ja me Britaninë e Madhe, sipas marrëveshjes që ata kanë nënshkruar për Brexit?

Mesa jam në dijeni dhe mesa dëgjuam këtu, shpesh ne jemi të detyruar, të imponuar nga një farë “diktati” i BE-së, për të respektuar qoftë kuotat, qoftë edhe tarifatat. Nuk e di sa mund të vazhdojë kjo dhe sesi mund të jetë në të ardhmen ky bashkëpunim?

Faleminderit!

Gjithsesi, unë jam dakord me projektligjin dhe e miratoj atë.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Karamelo!

Kush e do fjalën për t’u përgjigjur?

Zëvendësministri Tare.

Agron Tare – Për pjesën politike, nëse e kuptova drejt pyetjen, po të lexoni edhe relacionin shpjegues, por edhe tekstin e marrëveshjes, bëhet fjalë për një rregullim, për një vazhdimësi, meqenëse Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda e Veriut dolën nga Bashkimi Europian, ne po e bëjmë këtë marrëveshje për të vazhduar të njëjtat kushte të tregtisë. Nuk jemi të detyruar, nuk është se kemi ndonjë diktat. Për pjesën e kuotave mund të falsin edhe zëvendësministrat e tjerë. Po nga pjesa politike është kjo vazhdimësi, pra nuk shikoj ndonjë problem.

Nuk e di sesa jam i qartë?

Mimi Kodheli – Zëvendësministri Kadia.

Besart Kadia – Atëherë, përshëndetje edhe një herë!

Për sa i përket diskutimit ose pyetjes së bërë pak më përpara, Mbretëria e Bashkuar në tërësi ka dashur të mbajë të njëjtat kuota me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ashtu siç janë të nënshkruara edhe me Marrëveshjen e Stabilizim – Asocimit, e cila është në kuotën 13,6%. Në këto diskutime nuk është se Shqipëria ka ndonjë disavantazh apo ndonjë

aftësi tjetër negociuese që nuk e ka pasur të tjerët kështu që janë pothuajse marrëveshje të ngjashme me të gjitha vendet e tjera.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ermira Gjeçi – Lidhur me kuotat, unë e përmenda ashtu sikurse edhe zëvendësministri, 13,6% - i ka qenë i panegociueshëm dhe ka qenë në vijim të Marrëveshjes së Stabilizim - Asocimit. Unë dua të ndaj me ju që niveli i eksporteve dhe importeve me Mbretërinë e Bashkuar nuk është në nivelet e duhura, por pritshmëritë janë të mëdha. Dua ta lidh këtë edhe me pyetjen që bëri zoti Gjoni. Nenin 8 ne e kemi lënë të hapur, sepse jemi duke analizuar të gjitha efektet që do të ketë, por nëpërmjet politikave të mira dhe mbështetjeve, ashtu sikurse është skema e IPARD-it, por edhe pjesa e donacioneve, ne synojmë rritjen e produkteve shqiptare, qëllimi final i të cilave është eksporti, që kanë qenë në vlera dhe në tregues shumë të mirë gjatë kësaj periudhe krahasuar me vitet e mëparshme, por jo aty ku ne pretendojmë të jenë.

Prandaj, ka një fokus akoma më të madh për politika dhe iniciativa të tilla në mënyrë me synim rritjen e tyre dhe rritjen e eksporteve jo vetëm në vendet e Bashkimit Europian, por edhe në vendet e tjera. Ne aktualisht eksportojmë me Mbretërinë e Bashkuar bimë mjekësore, bukë, torta, kek, biskota. Për bimët mjekësore, nëpërmjet skemave kombëtare, por ashtu edhe të IPARD-it, ashtu edhe me IPARD 3, për të cilin aktualisht jemi duke u marrë me masat të cilat do të prezantohen në vitin 2022, janë të futura. Pra, kjo është mënyra se si duke parë edhe trendin që ka Ministria e Bujqësisë bën politikat, merr iniciativat e duhura për mbështetjen e të gjithë fermerëve në ato fusha ku ka kërkesë në rritje.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Besoje se kolegët janë të qartë, ndaj me lejen tuaj e hedhim projektligjin në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes të partneritetit të tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”? Të gjithë janë dakord. Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Të gjithë janë dakord. Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Të gjithë janë dakord.

Faleminderit!

Nuk është e nevojshme t'i citoj kolegët.

E hedhim në votim në tërësi marrëveshjen? Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit zotërinj zëvendësministra dhe punonjës të tjerë!

Faleminderit, kolegë!

Shihemi në seancë.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA